

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Aktitekturës kërkon të punësojë një laborant me arsim të lartë.

1. Kandidati, duhet të jetë diplomuar në Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë, ose në Programet e Studimit të Ciklit të Parë, dhe/ose të Ciklit të Dytë, në UPT, përkatësisht në:

- Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës;
- Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit; (Inxhinieri Ndërtimi dhe Gjeodezi)
- Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit (Elektronikë);

2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare, me një notë mesatare ≥ 7 (shtatë).

3. Preferohet të ketë njohuri në pajisje laboratorike, që kanë të bëjnë me fushën e Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës (total station, 3D scanner, etj. dhe programet respektive).

4. Të ketë njohuri në programet e Microsoft Office (Word, Excel, Power Point, etj.), Auto CAD dhe Photoshop.

5. Të njohë një gjuhë të huaj perëndimore, të mbrojtur dhe vërtetuar me dëshmi (preferohen gjuhët anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht).

6. Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

7. Preferohet të ketë eksperience pune mbi 2 vite.

8. Preferohet të ketë njohuri mbi Statutin e UPT-së dhe rregulloret e FAU-t, të cilat ndikojnë në ecurinë dhe mbarëvajtjen e departamentit.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **29.01.2021** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Curriculum Vitae;
3. Diploma e studimeve universitare dhe lista e notave të noterizuara. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
4. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
5. Kopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Certifikatë kualifikimi dhe trajnimesh të ndryshme (në rast se ka);
7. Dëshmi e gjuhës së huaj e noterizuar;
8. Raport mjekësor për aftësi në punë;
9. Dëshmi penaliteti ose formular vetëdeklarimi.
10. Dy letra referencash.

